



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin tematik të ushtruar në “Universitetin e  
Sporteve Tiranë”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**

**AUDITIMIN TEMATIK  
NE**

**UNIVERSITETIN E SPORTEVE TIRANË**

**Dhjetor 2023**

## **Përmbajtja**

### **faqe**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve .....	3-4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	4
II. HYRJA .....	5
1. Objekti i auditimit .....	5
2. Qëllimi i auditimit .....	5
3. Identifikimi i çështjes:.....	5
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:.....	5
5. Përgjegjësitë e audituesve: .....	6
6. Kriteret e vlerësimit .....	6
7. Standardet e auditimit .....	6
8. Metodatat e auditimit .....	6
9. Dokumentimi i auditimit.....	7
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....	7
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim .....	7
1. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT .....	7
2.1 <i>Procedura e prokurimit procedure e hapur me objekt “Blerje pajisje profesionale .....</i>	7-13
2.2 Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST .....	14-20
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....	20-23

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 11.07.2023 deri me datë 25.09.2023 kreu auditimin tematik në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në bazë të ankesave të administruara pranë KLSH-së, për të cilat janë mbajtur akt-konstatimet përkatëse si dhe është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Në dy procedurat e prokurimit për të cilat u krye ky auditim u konstatuan mangësi dhe pasaktësi në realizimin e procedurave. Problematika janë konstatuar në zbatimin e dispozitave ligjore të prokurimit publik, si dhe ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Nga auditimi u konstatuan mangësi dokumentacioni në llogaritjen e vlerës së kontratës dhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

Ne këtë periudhë pas marrjes së observacioneve përkatëse grupi i auditimit hartoi raportin përfundimtar ,ku me poshtë po paraqesim gjetjet kryesore:

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Procedura e prokurimit procedure e hapur me objekt "Blerje pajisje profesionale Parregullsi në hartimin e regjistrave të prokurimeve dhe identifikimin e nevojave të institucionit për pajisjet e tenderuar.	7-13	E lartë	1. Nga UST të merren masa për administrimin e kërkesave për identifikimin e nevojave reale të institucionit për mallra dhe shërbime ,duke i pasqyruar në projekt buxhetet përkatëse dhe në regjistrat e parashikimeve për prokurimet publike ,sipas përcaktimeve të ligjeve në fuqi. 2. Nga UST të merren masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit me synim realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.
2	Parregullsi në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Mungon përllogaritja e fondit limit.	7-13	E lartë	Nga UST, njësia e prokurimit në të gjitha rastet të ndjek në mënyrë rigorozë etapat e zhvillimit dhe dokumentimit të procedurës së prokurimit me qëllim transparencën e plotë dhe arritjen e objektivave.
3	Kërkesat kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë.	7-13	E lartë	Nga UST, njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që të stimulohet konkurrenca dhe që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën e kontratës.
4	Mungesë të eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitet në përdorimin e fondeve.	7-13	E mesme	1.UST, autoriteti kontraktor të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të institucionit arritjen e një prokurimi me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet duke respektuar parimin e konkurrencës. 2.UST për artikujt e papërdorur të marra masa për vlerësimin e tyre dhe ti vendos në funksion të nevojave dhe shërbimeve që ka universiteti.

5	Procedura e prokurimit "Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST", viti 2010. Mangësi në mbajtjen dhe hartimin e dokumentacionit.	14-20	E mesme	UST, administratori në çdo rast dhe për çdo element të aseteve të institucionit të ndërmarr hapat dhe të hartoi dokumentacionin përkatës për çdo lëvizje të aseteve të blera dhuruara apo ekzistuese të tij, pasi është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe duhet të dokumentoj veprimet e ndërmarra për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka në pronësi.
---	---	-------	---------	---

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

-Në lidhje me procedurën "Blerje pajisje profesionale", konstatohet se për këtë procedurë nuk administrohen kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes së saj.

-Në lidhje me specifikimet teknike të pajisjeve u konstatua se specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik.

Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjenden në magazinë të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt duke mos justifikuar blerjen e tyre, për artikujt:

-Biqikleta për ture copë 40 me vlerë 1,584,000 lekë me TVSH.

-Set Zhytjeje copë 50 me vlerë 540,000 lekë me TVSH.

-Mangësi në mbajtjen dhe hartimin e dokumentacionit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik".

Nisur nga sa me sipër titullari i AK-së nuk duhet të kishte iniciuar fillimin e kësaj procedure prokurimi në mungesë të dokumenteve justifikuese nga sektorët përkatës për artikujt e tenderuar. Autoriteti kontraktor ka vepruar duke u mbështetur në plan buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm për inicimin e kësaj procedure.

#### Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të UST-së:

Strukturat drejtuese të Universitetit të Sporteve, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të Universitetit të Sporteve janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

#### Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>1</sup>, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e

sigurisë, së auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionin e auditimit janë të përshtatshme.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 399/1 prot., datë 11.07.2023, nga data 11.07.2023 deri 28.07.2023 dhe autorizimit nr. 399/7 prot., datë 12.09.2023, në Universitetin e Sporteve të Tiranës , u krye auditim “Tematik” me përbërje:

1. V.B. , përgjegjëse grupi,
2. S. H., auditues.

### **1. Objekti i auditimit**

-Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuarat si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: Standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë, që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Auditimi ka për qëllim;

- vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Universiteti i Sporteve ,Tiranë.
- dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

### **3. Identifikimi i çështjes:**

Raporti mbi përputhshmërinë e auditimit tematik në Universitetin e Sporteve, Tiranë për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje profesionale”, me REF -066325-04-30-2018, viti 2018 ka identifikuar sipas kriterëve të specifikë të auditimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Unifikimi i specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj në përputhje me standardet e miratuara dhe katalogëve të standardeve të miratuara;
- Përlllogaritja e fondit limit për përcaktimin e të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, para publikimit të tenderit dhe vënia në dijeni e Autoriteteve Kontraktore;
- Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullave përkatëse të prokurimit publik, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
- Shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit, nënshkrimit të marrëveshjeve kuadër.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave nga autoritetet kontraktore dhe hartimi i raporteve të monitorimit për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Stafi drejtues është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor. Ky Institucion duhet që të menaxhojnë burimet dhe të ushtrorë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve:**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (ISSAI 1500/ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Në jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, në besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003 ; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Ligji 44/2015 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.57 , datë 29.01.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë të UST-së” i ndryshuar; .

## **7. Standardet e auditimit**

-ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*);

-ISSAI 4000- (*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*);

ISSAI 400 - (*Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*);

- SNA) të IFAC - (*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*);

-Manual i IDI-t -(*Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë*);

-*Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së*;

-*Kodi etik i KLSH*.

## **8. Metodatat e auditimit**

Auditim tematik.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga Audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtur, observacioneve të paraqitura u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

## II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Universiteti i Sporteve të Tiranës është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor e sportiv, person juridik publik, me status të veçantë, i njohur me ligj si i tillë.

2. Universiteti i Sporteve të Tiranës përdor akronimin UST.

3. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe në rregulloret e tij.

### 2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u vërejt parregullsi e përbashkët mos përputhja me kriteret dhe rregullat në procedurat e prokurimit publik të audituara, trajtuar më poshtë sipas objektit të tenderimit në:

**2.1. Procedura e prokurimit procedure e hapur me objekt “Blerje pajisje profesionale, me REF -066325-04-30-2018, viti 2018.**

<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 7 prot 608 datë 17.04.2018	<b>3. Hartuesit e dokumenteve te tenderit</b> -F. J , me detyrë drejtoreshë e drejtorisë juridike (për periudhën) -F. M , me detyrë Dekan i fakultetit të veprimtarisë fizike dhe rekreacionit -S. Sh, me detyrë Drejtor i drejtorisë së marrëdhënieve me jashtë ,publikun dhe studentet	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr.16,prot 608/1 datë 30.04.2018 - K. K ,Kryetar (Profesor i asociuar tek fakulteti i shkencave te lëvizjes ) -F. M me profesion pedagog (larguar nga puna) -E. I Profesor doktor /staf akademik ,fakulteti i shkencave te lëvizjes
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 12,500,000	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 11,632,000	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)</b> 868,000
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 17.06.2018	<b>9. Burimi Financimit</b> Fond nga Te ardhurat dytësore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>2</u> _OE b) S’kualifikuar <u>1</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> _OE
<b>11. Ankimime Pranë AK - ka Formulari i ankesës me nr. 839 datë 22.05.2018</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> - ka ..... Kthim përgjigje me shkresën numër 839/1 date 23.05.2018	<b>13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik</b> - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> nr. 608/7, datë 13.07.2018	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 13,958,400 Lekë	<b>16. Afati i kontratës në dite</b> 60 ditë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2018 është parashikuar blerja e artikujve “Pajisje profesionale” pa pasur kërkesa për këto artikuj, duke mos justifikuar kështu blerjen e këtyre artikujve dhe shpenzimin për to, kjo në kundërshtim me VKM 914, datë 24.12.2014 ,neni 12,pika 2.a, “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” ku parashikohet shprehimisht se: “2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të

*lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:*

*a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;”*

Po ashtu është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 09 datës 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku parashikohet shprehimisht se:

*“Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijëni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijëni nëpunësit zbatues”*

Me shkresën me nr. 608 prot., datë 17.04.2018 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit Procedure e hapur me objekt “Blerje pajisje profesionale” me fond limit 12,500,000 lekë pa TVSH dhe 15,000,000 lekë me TVSH. Në dokumentacionin e administruar për këtë procedurë mungon llogaritja e fondit limit e dokumentuar. Fondi limit është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në urdhrin e prokurimit pa ngritjen e një grupi të posaçëm për hartimin e fondit limit ose lënien e hartimit të këtij fondi njësisë së prokurimit, veprim ky në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni, 57 “Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit ,neni 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

*“1. Për llogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*

*Në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe*

*A) çmimet e tregut;ose/dhe*

*b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe*

*ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.*

*2. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë për llogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”*

*Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i autoritetit kontraktor M. G dhe njësia e prokurimit e përbërë nga F. J, F. M, S. Sh.*

#### Hartimi i kërkesave për kualifikim

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit nuk janë argumentuar kriteret e përcaktuara dhe të miratuara, për këtë procedurë prokurimi, kjo në kundërshtim me VKM 914/2014, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ,pika 2, ku parashikohet shprehimisht se :



*“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.”*

Nga auditimi i dosjes fizike të administruar pranë UST u evidentua ankesa nr. 839 prot., datë 22.05.2018, e cila ka ardhur për dokumentet standarde të tenderit dhe specifikimet teknike. Gjithashtu në sistemin elektronik të prokurimeve SPE është administruar edhe një ankesë elektronike sqarim për specifikimet teknike, të dyja këto ankesa paraqesin kundërshtimet e tyre në hartimin specifikimeve teknike nga AK për këtë procedurë duke e ngushtuar konkurrencën. Kjo ankesë nuk është pasqyruar në asnjë raport të procedurës duke u justifikuar si e ardhur jashtë afatit. Nga auditimi i elementeve të ankesës vihet re se ankimuesi OE A. S. G ka bërë me dije se për çdo pajisje të kërkuar specifikimet teknike orientojnë në një produkt të vetëm. Grupi i auditimit bëri një verifikim në rrjetet elektronike për të verifikuar dhe besueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se për secilin produkt specifikimet e vendosura nga njësia e prokurimit kufizojnë ndjeshëm tregun dhe e orientojnë atë drejt një produkti të vetëm.

Më hollësisht pretendimet e ankimuesve lidhen me pajisjet si me poshtë:

*Nga ankesa Pasi shqyrtoam specifikimet teknike vumë re se janë tepër të saktësuar dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.*

*Në lidhje me produktin e parë, pistën e vrapimit, prodhim i kompanisë I. H. & F. (kodi i produktit PFTL99716) është përcaktuar pesha e produktit si dhe përmasat.*

*-Vendosja e këtyre dy elementeve të pa nevojshme për mirëfunksionimin e pajisjes ndikon ndjeshëm në uljen e konkurrencës, pasi qofte pesha ashtu dhe përmasat nuk ndikojnë në funksionim e saj.*

*Produktin me kod Ultra 7136, kërkohet rripi i markës Hutchinson!!, kur ndërkohë tipin e rripit 5PK, nëse do e marrim ne konsiderate, e prodhojnë shume kompani te tjera.*

*-Vendosja e një emërtimi marke produkti qofte edhe jo direkt i pajisjes por pjese përbërëse të saj sjell kufizim te konkurrencës.*

Gjithashtu në ankesën e paraqitur nga OE A. S. G në paragrafin 4 paraqitet pretendimi se:

*...Në vijim të argumentit të mësipërm , ju bëjmë me dije se specifikimet e produkteve tuaja janë hartuar ne kundërshtim me nenin 20 mosdiskriminimi (bie ndesh me kërkesën për autorizim prodhuesi qe ju keni kërkuar , pasi për produkte unike, është e pamundur qe 2 operatore ekonomike te sigurojnë letër autorizim për këtë procedure) , neni 23 specifikimet teknike (bie ndesh me produktet qe ju keni kërkuar, me poshtë po listojmë kodet e produktit te kërkuar).*

*Disa nga produktet kufizuar nga kodet, Për shembull:*

*PFTL99716*

*1. Kompania I. H. & F.-kodi*

*2. Kompania JK F.-kodi Ultra 7136*

*3. Kompania H. F. E. Co., L. - kodi HT-5000*

*4. Kompania AAI(R) - kodi Elite Unevens with Graphite E Bouncy Bar Rails*

*5. Kompania B..-kodi 6-Cabled Single Bar Trainer*

Grupi i auditimit bëri një krahasim të pretendimeve të ankimuesve në page dhe konstatoi se specifikimet teknike të vendosura nga AK orientojnë procedurën në përzgjedhjen e produkteve të sipërcituara duke e kufizuar pjesëmarrjen me produkte ekuivalente, në

kundërshtim me nenin 23, ligji nr. 9643 date 20.12.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pika 2 dhe 5, ku shprehimisht parashikohet se:

*"2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*5. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."*

*Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga F. J. F. M, S. Sh.*

#### Zhvillimi i procedurës

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 25.05.2018, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 (katër) operator ekonomik, dy nga të cilat nuk kanë paraqitur ofertën ekonomike dhe operatorët "B. S" sh.p.k., me ofertë në vlerën 11,632,000 lekë pa TVSH dhe "B" sh.p.k., me ofertë me vlerë 11,914,450 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 608/4 prot., datë 18.06.2018, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik "B. S" sh.p.k., me ofertë në vlerën 11.632.000 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i produkteve të ofruara nga OE i shpallur fitues u konstatua se karakteristikat teknike të produkteve të përshkruara në specifikimet teknike janë njësoj me katalogun e produkteve të OE fitues "B. S", duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasojë kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës. Në vijim është lidhur kontrata me nr. 608/7 prot., datë 13.07.2018, ndërmjet UST të përfaqësuar nga M. G, në cilësinë e administratorit dhe operatorit ekonomik "B. S" sh.p.k. në vlerën 13,958,400 lekë me TVSH, kohëzgjatja e kontratës është me afat 60 ditë, me datë fillimi nënshkrimin e saj.

#### Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e aktit të marrjes në dorëzim, fletë-hyrjet dhe fletë-daljet nga magazina u konstatua se produktet e kontratës nr. 608/7 date 13.07.2018 janë bërë hyrje pranë magazinës së UST sipas flet-hyrjes nr. 35 datë 10.09.2018, 17 zëra pajisjesh me një vlerë prej 12,962,400 lekë me TVSH sipas aktit të marrjes në dorëzim nr. 608/11 prot. datë 13.09.2018. Me flet hyrje nr. 40 datë 31.10.2018, janë furnizuar edhe 4 zërat e mbetur 17 zëra pajisjesh me një vlerë prej 996,000 lekë me TVSH sipas aktit të marrjes në dorëzim nr. 608/13 prot., datë 09.11.2018. Për këto produkte të furnizuara me vonesë është mbajtur penaliteti sipas kushteve të kontratës nr. 608/7 datë 13.07.2018 sipas nenit 23 pika 23.1 germa a në vlerën prej 697,920 lekë dhe likuiduar vetëm diferenca prej 298,080 lekë duke zbritur garancinë prej 5%. Nga verifikimi në terren të produkteve që gjenden në magazinë të pa shpërndara u konstatuan se artikulli 19 sipas aneksit të kontratës Biçikleta për ture copë 40 gjendet në magazinë i pa përdorur duke mos përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre me vlerë 1,584,000 lekë me TVSH. Artikulli 18 sipas aneksit të kontratës Set Zhytjeje copë 50 gjendet në magazinë i pa përdorur duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre me vlerë 540,000 lekë me TVSH. Gjithashtu për këtë produkt mungon çanta sipas specifikimeve teknike.

## **Konkluzion**

-Në lidhje me procedurën “Blerje pajisje profesionale”, konstatohet se për këtë procedurë nuk administrohen kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes së saj. Në lidhje me specifikimet e vendosura të pajisjeve u konstatua se këto specifikime kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik. Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjenden në magazine të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.

<b>Titulli i gjetjes nr. 1</b>	Parregullsi në hartimin e regjistrave të prokurimeve dhe identifikimin e nevojave të institucionit për pajisjet e tenderuar.
<b>Situata:</b>	Në lidhje me procedurën “Blerje pajisje profesionale”, konstatohet se për këtë procedurë nuk administrohen kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes së saj.
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji 9643, datë 20.11.2006 ,neni 12,pika 2.a, “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” <u>ku përcaktohet se:</u> 1. <i>Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, që i janë vënë në 9 dispozicion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.</i> “2. <i>Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna: a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës; b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar; c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente; ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës; d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre; dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi; e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave; ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;</i></p> <p>Udhëzimi nr. 09 datës 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku përcaktohet se: “<i>Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e</i></p>

	<i>prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues”.</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risk për shpenzime pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Mos vëmendje e duhur institucionale.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	<p>1. Nga UST të merren masa për administrimin e kërkesave për identifikimin e nevojave reale të institucionit për mallra dhe shërbime duke i pasqyruar në projekt buxhetet përkatëse dhe në regjistrat e parashikimeve për prokurimet publike, sipas përcaktimeve të ligjeve në fuqi.</p> <p>2. Nga UST të merren masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit me synim realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.</p>

<b>Titulli i gjetjes nr.2</b>	Parregullsi në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Mungon përlllogaritja e fondit limit.
<b>Situata:</b>	Në dokumentacionin e administruar për këtë procedurë mungon llogaritja e fondit limit e dokumentuar. Fondi limit është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në urdhrin e prokurimit pa ngritjen e një grupi të posaçëm për hartimin e fondit limit ose lënien e hartimit të këtij fondi njësisë së prokurimit veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni, 57 “Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.
<b>Kriteri:</b>	Ligji Nr.9643 date 20.11.2006 ,Neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 57 “Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës ku përcaktohet se:1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është 35 ngarkuar një strukture të posaçme. 2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesë transparence në realizimin e procedurës së prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos vëmendje e duhur institucionale.

<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Nga UST, njësia e prokurimit në të gjitha rastet të ndjek në mënyrë rigorozë etapat e zhvillimit dhe dokumentimit të procedurës së prokurimit me qëllim transparencën e plotë dhe arritjen e objektivave.

<b>Titulli i gjetjes nr. 3</b>	Kërkesa kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në procedurë.
<b>Situata:</b>	Specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik. Nga verifikimi i produkteve të ofertuar nga OE i shpallur fitues u konstatua se karakteristikat teknike të produkteve të përshkruara në specifikimet teknike janë njësoj me katalogun e produkteve të OE fitues, duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasoje kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 20, neni 23 . VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 <i>ku përcaktohet se:1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit. 2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Dokumentet e tenderit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Nga UST, njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që të stimulohet konkurrenca dhe që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën e kontratës.

<b>Titulli i gjetjes nr. 4</b>	Mungesë të efijencës, efektivitetit dhe ekonomicitet në përdorimin e fondeve.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjendën në magazine të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre.
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 12

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga strukturat e prokurimit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandime:</b>	1. UST, autoriteti kontraktor të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të institucionit arritjen e një prokurimi me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet duke respektuar parimin e konkurrencës. 2. UST për artikujt e papërdorur të marra masa për vlerësimin e tyre dhe ti vendos në funksion të nevojave dhe shërbimeve që ka universiteti.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

- M. G me detyrë Administratore në cilësinë e titullarit të AK, për iniciimin e procedurës, dhe kryerjen e saj.
- F. J në cilësinë e kryetares së Njesisë së Prokurimit
- F. M në cilësinë e specialistit të fushës në Njesisë e Prokurimit
- S. Sh anëtare e Njesisë së prokurimit

**2.2 Procedura e prokurimit “Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST”, viti 2010, me fond limit 8,598,800 lekë pa TVSH, i shtuar në Regjistrin e Parashikimit vjetor për vitin 2010.**

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi nr. nr. 13</b> datë 23.11.2010 Njësinë e prokurimit: F. J, S. Sh, R. M	<b>3. Specifikimet teknike</b> Me anë të urdhrit nr. 41, datë 23.11.2010 është ngritur grupi I punës për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje : E. S, A. L dhe E. N	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> , Urdhri nr. 12 datë 28.02.2011 Komisioni i përbërë nga: M. G, A. P, G. P, A. L dhe E. S.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Shoping sipas manualit të Bankës Botërore	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> A. shpk me ofertë 8,560,600 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 38,200 lekë
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,598,800 lekë	<b>9. Burimi Financimit nga</b> Banka Botërore	<b>10. Operatorët Ekonomike</b> A. me ofertë 8,771,416 lekë A. shpk me ofertë 8,560,600 lekë B.E me ofertë 9,004,427 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 02.03.2011	<b>11. Ankimim</b> Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK –nuk ka
<b>11. Ankimim</b> Pranë AK- nuk ka; APP- nuk ka; KPP- nuk ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës</b> nga AK –nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës</b> nga KKP –nuk ka
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata nr. 184/4, datë 15.04.2011, me vlerë 8,560,600 lekë, me afat deri 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh) lekë:</b>	<b>16. Likuiduar</b> -Urdhër shpenzimi nr. 160, datë 03.06.2011 Vlera 4.464.600 Lekë -Urdhër shpenzimi nr. 188/1, datë 06.07.2011 Vlera 3,996,000 Lekë

### Fondi Limit:

Fondi akorduar nëpërmjet shkresës nr. 5850 prot., datë 16.09.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës miratuar nga projekti i bankës botërore “Cilësi dhe barazi në arsim” për projektet “UNILAB” viti 2010.

Pas marrjes së fondit të akorduar, Universiteti i Sporteve ka nisur shkresën nr. 434/2 prot datë 27.09.2010 për mallrat, shërbimet dhe specifikimet teknike për projektin procedurën e prokurimit me titull “*Reformimi i metodologjisë dhe i teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në universitetin e sporteve Tiranë*”. Procedura e prokurimit më pas është e iniciuar dhe kërkuar nga shkresa e Ministrisë së Arsimit nr. 5258/1 prot. datë 16.08.2010 me lëndë “Dërgohet lista e projekteve fituese UNILAB, për vitin 2010” ku ndër universitet e tjera paraqitet dhe Universiteti i Sporteve. Me shkresën nr. 5850 prot. datë 16.09.2010 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit kërkohet informacion në lidhje me planifikimin e investimeve për vitin 2010 në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim” projekt i financuar nga banka e Këshillit të Europës për Zhvillim.

### Procedura e prokurimit:

Me shkresën nr. 618 prot. datë 23.11.2010 titullari i autoriteti kontraktor z. V. R. ka nxjerrë urdhër prokurimin nr. 13 datë 23.11.2010 për procedurën shoping “Furnizim me pajisje për universitetin e sporteve Tiranë” në kuadër të “projektit cilësi dhe barazi në arsim” me vlerë 8,598,800 lekë dhe njësi prokurimi të përberë nga F. J- Kryetare, S. Sh dhe R. M anëtare. Me shkresën nr. 618/1 prot datë 23.11.2010, urdhër i brendshëm nr. 41 datë 23.11.2010 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve elektronike që do të blihen me fondet e bankës botërore i përbërë nga E. S -specialist IT, A. L- pedagoge informatike dhe E. N -specialist i jashtëm. Pas hartimit të specifikimeve me shkresën nr. 653 prot., datë 06.12.2010 titullari i AK e ka dërguar për miratim pranë Ministrisë së Arsimit dhe të shkencës. Pas një komunikimi të gjatë me e-maile të njëpasnjëshëm më datë 29 mars 2011 është marrë “No objection” nga banka botërore për specifikimet teknike dhe zhvillimin e procedurës. Pas Zhvillimit të procedurës rezulton se kanë marrë pjesë 3 Operatorë Ekonomikë me ofertat si më poshtë:

A. me ofertë ekonomike 8,77,416 lekë

A. shpk me ofertë ekonomike 8,560,600 lekë

B. E me ofertë ekonomike 9,004,427 lekë. Nga renditja përfundimtare nuk pati kundërshtime.

Me shkresën nr. 184/4 prot., datë 15.04.2011 u lidh kontrata me Operatorin Ekonomik “A” shpk.

Me shkresën nr. 184/5 datë 04.05.2010 është dërguar shkresa në APP për botimin e kontratës.

### Likuidimi i mallrave:

-Me urdhër shpenzimin nr. 188/1 datë 06.07.2011 është kryer likuidim pjesor me vlerë 3,996,000 lekë, ku bashkëngjitur është certifikata e pranimit datë 13.05.2011 e nënshkruar nga drejtuesi i projektit A. K dhe rektori V. R, fletë hyrja përkatëse datë 13.05.2011, fletë garancia datë 13.05.2011, flet dorëzimi i mallit datë 13.05.2011 etj.

-Me urdhër shpenzimin nr. 160 datë 03.06.2011 është kryer likuidim pjesor me vlerë 4,464,600 lekë ku bashkëngjitur është certifikata e pranimit datë 09.05.2011 e nënshkruar nga A. K, M. G, E. S, I. M dhe rektori V. R., flet hyrja përkatëse datë 9.05.2011, flet garancia, etj. Në certifikatën e pranimit të nënshkruar nga grupi i punës dhe rektori citohet se: *...Ju njoftojmë se mallrat e dorëzuara (sipas kontratës) janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë. Në përputhje me termat e kontratës, Enti prokurues merr në dorëzim mallrat bashkë me përgjegjësinë për kujdesin dhe ruajtjen nga humbja nisur nga data e përcaktuar më poshtë... Data e pranimit 09.05.2011 Kjo letër nuk ju përjashton nga*

*detyrat e tjera sipas kushteve të kontratës apo nga detyrimet tuaja gjatë periudhës së garancisë.*

Siç vihet re dhe nga dokumentacioni procedura ka përfunduar me sukses dhe është dorëzuar entit prokurues të cilët e kanë marrë në dorëzim.

#### Funksionaliteti i programeve (softeve):

Nga Intervistat verbale me punonjësen e sekretarisë M. M dhe punonjësen e bibliotekës M. Xh., që kanë në ngarkim sistemin përkatës softin e bibliotekës dhe atë të sekretarisë mësimore, na bëjnë me dije se këto dy sisteme kanë operuar për një kohë të shkurtër rreth dy vite. Në 25.02.2014 me shkresën me nr. 14-034/2 prot., është nëshkruar një marrëveshje konfidencialiteti mes UST dhe qendrës Ndëruniversitare të shërbimeve dhe rrjetit Telematik e cila mbështetet në ligjin nr. 9704 të datës 02.04.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telepatik për Universitet”. Kjo marrëveshje konfidenciale solli instalimin e dy programve të reja softare për sekretarinë mësimore dhe atë të bibliotekës të cilat operojnë edhe sot me Upgraded përkatëse.

#### Zbatimi i kontratës:

Për sa i përket pajisjeve të ardhura në UST sipas procedurës së prokurimit të Raporti Përfundimtar i Auditimit, sipërcituar, të gjitha pajisjet dhe dy softet (që konsistojnë në dy CD ) janë gjendje me material brenda por që është e pa mundur të shihet përmbajtja. Këto mallra janë në ngarkim të stafit administrativ dhe akademik të Universitetit të Sporteve Tiranë sipas rastit. Nga grupi i auditimit u verifikua ekzistenca e dy softeve që gjendeshin në dy CD përkatëse, u verifikuan ekzistenca e pajisjeve PC dhe serverëve përkatëse të cilat janë gjendje fizikisht por jo në punë për efekt të vjetërsisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton që nuk ka dokumentacion për funksionimin e pajisjeve (për periudhën që kanë funksionuar) dhe nuk ka dokumentacion për zëvendësimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë funksionit, kjo në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet qarte se:

*“Përgjegjësia e Nëpunësve Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike.*

*6. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jete i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.*

*7. Nëpunësit Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre dhe japin llogari në linje hierarkike deri tek Nëpunësi Autorizues i njësisë publike.*

*8. Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike dhe jep llogari tek Titullari për mënyrën e funksionimit të tyre”.*

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi M. G në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe administratorit të institucionit për periudhën.*

#### Konkluzion:

Si konkluzion nga verifikimi në terren dhe intervistat verbale me personat përgjegjës të dy softet e blera dhe të instaluar në ambientet e UST, Software për bibliotekën dhe ai i sekretarisë mësimore janë instaluar dhe vendosur në gjendje punë për një kohë të shkurtër



maksimalisht 2 vite, pasi nga një projekt tjetër, kësaj rradhe financuar nga qeveria Italiane këto software u hoqën dhe u vendosën të tjerë të cilët janë në punë edhe sot. Vlen të theksohet një vjedhje e ndodhur në UST e cila preku edhe disa pajisje të blera nëpërmjet procedurës së prokurimit “Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST” ngjarje e cila është kallëzuar në prokurori dhe në rajonin e policisë përkatës sipas shkresës nr. 859 prot., datë 31.12.2014. Nga ana e UST-së në inventarët periodik këto softëare ekzistojnë. Në shkresën për inventarizimin e fundit të kryer nga UST, në korrik të vitit 2023, këto pajisje (2 software-t e sipërcituar), ishin jashtë funksionit por akoma gjendje.

Për sa më lart dhe kohës së gjatë që ka kaluar nuk mund të përcaktohet qartë efektshmëria e funksionimit dhe punës së kryer nga këto sisteme, por nga ajo që na u tha nga punonjës të ndryshëm të UST-së, pajisjet kanë funksionuar për një periudhe të shkurtër kohore, janë përdorur për hedhjen e të dhënave për studentet dhe për listimin e librave të bibliotekës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton që nuk ka dokumentacion për funksionimin e pajisjeve (për periudhën që kanë funksionuar) dhe nuk ka dokumentacion për zëvendësimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë funksionit.

<b>Titulli i gjetjes nr. 5</b>	Mangësi në mbajtjen dhe hartimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit : <i>“Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST”</i>
<b>Situata:</b>	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton që nuk ka dokumentacion për funksionimin e pajisjeve (për periudhën që kanë funksionuar) dhe nuk ka dokumentacion për zëvendësimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë funksionit.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 30 datë 27.11.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> pikat 5,6,7,8 dhe 10 <u>ku përcaktohet se: Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike</u> <sup>3</sup> 5. <i>Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike</i> <sup>4</sup> në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi. <i>Përgjegjësia e Nëpunësve Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike</i> <sup>5</sup> 6. <i>Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jete i qarte dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivitetet e njësisë. 7. Nëpunësit Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre</i> <sup>6</sup> dhe japin llogari në linje hierarkike deri tek Nëpunësi Autorizues i njësisë publike. 8. <i>Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike dhe jep llogari tek Titullari për mënyrën e funksionimit të tyre. Përgjegjësitë e menaxhereve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike</i> 10. <i>Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë</i>

	<i>publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.</i>
<b>Ndikimi/Efekt:</b>	Mos justifikim i veprimeve të ndërmarra.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga strukturat drejtuese.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandime:</b>	UST, administratori në çdo rast dhe për çdo element të aseteve të institucionit të ndërmarrë hapa dhe të hartojë dokumentacionin përkatës për çdo lëvizje të aseteve të blera dhuruara apo ekzistuese të tij, pasi është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe duhet të dokumentoj veprimet e ndërmarra për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka në pronësi.

*Për veprimet dhe mosveprimet e cilësuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi administratori i UST-së M. G*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga F. M është paraqitur observacioni me shkresën pa numër prot. administruar pranë KLSH-së me nr. 399/16 prot., datë 27.10.2023 “*Observacion mbi Projekt Raportin të mbajtur nga audituesit shtetëror të autorizuar të KLSH-së në UST*”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendimi i subjektit:**

*.....Sikurse e kam përmendur në observacionin nr 1, të gjitha kërkesat për materiale të ndryshme vijnë nga Departamentet përkatëse dhe sigurisht që unë vihem në dijeni për to. Kërkesat që bëhen nga Departamentet paraqiten çdo vit dhe jo të gjitha plotësohen për arsye se Universiteti ka dhe Fakultete të tjera të cilat paraqesin kërkesat e tyre. Kështu që ato akumulohen dhe plotësohen në një vit ushtrimor pasardhës bashke me kërkesat e radhës. Një pjesë e mirë e kërkesave për pajisje janë bërë me kërkesë të ish Dekanit të FVFR (sot Rektori i UST) dhe me specifikisht në datë 07/07/2016 për Projekt Buxhetin afatmesëm 2017-2019 të cilat nuk u plotësuan në kohë. (dok. bashkëngjitur).*

*Me të drejte ju citoni se është konstatuar se janë blerë "Biçikleta për ture" pa asnjë kërkesë. Është detyre e Drejtueses së Autoritetit Kontraktor dhe e Kryetares së Njesisë së Prokurimit që të vinin në dispozicion shkresat përkatëse për këtë Artikull.*

*-Përsa i përket përlllogaritjes së Fondit Limit nuk kam marre pjese asnjëherë në procedura të tilla, përderisa nuk kam as formim ekonomik. Kjo vërtetohet lehtësisht nga Urdhri i prokurimit ku vlera e këtij fondi ishte paracaktuar nga struktura të tjera të Universitetit.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion arrin në konkluzionet e mëposhtme:*

*Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.*

Nga M. G është paraqitur observacioni me shkresën pa numër prot. administruar pranë KLSH-së me nr. 399/17 prot., datë 07.11.2023 “*Sqarime mbi Projekt Raportin e mbajtur nga audituesit e KLSH-së në UST*”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendimi i subjektit:**

*.....Në përputhje me afatin e lënë në shkresën tuaj, më poshtë po paraqes në mënyrë të detajuar sqarimet e mia në lidhje me këtë Projekt-Raport në të cilin janë bashkuar dy procedura auditimi, njëra prokurim i vitit 2018, pra para 5 vitesh dhe tjetra një procedurë e vitit 2010, pra para 13 vitesh të zhvilluara në këtë institucion.*

*Siç ju kam sqaruar në observacionet përkatëse të dërguara tek ju, për përgatitjen e sqarimeve të mia jam drejtuar me shkresë në UST për të bërë të mundur konsultimin me dokumentacionin e kontrolluar si dhe të kem mundësi për të gjetur dokumentacione të tjera sqaruese. Nga ana e tyre në mënyrë të qëllimshme më është vënë në dispozicion në limitet kohore të afatit për të dorëzuar përgjigjet vetëm disa pjesë të dokumentacionit të kontrolluar duke cënuar të drejtën time për të përgatitur të plotë dhe sipas afatit sqarimet e mia. Gjithashtu ju sqaroj se, më janë shkëputur marrëdhëniet financiare nga Universiteti i Sporteve të Tiranës më datë 15.03.2023.*

*Në gjetjen tuaj konstatoj se ka parregullsi në hartimin e regjistrave të prokurimeve dhe identifikimin e nevojave të institucionit për pajisjet e tenderuar. Për këtë siç kam përmendur dhe në observacionin e dërguar pranë jush në datë 07.08.2023, po ju sqaroj dhe njëherë që kërkesat për fillimin e kësaj procedure janë planifikuar që në projekt buxhetin e miratuar nga organet kolegjiale, të cilat do ti gjeni shkresat bashkëngjitur observacionit.*

*Gjetja nr.2: Parregullsi në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Mungon përlllogaritja e fondit limit .*

*Për këtë pikë kam sqaruar që për sa i përket fondit limit për procedurën "Pajisje Profesionale", sa jam në dijeni dhe kujtoj çmimet për llogaritjen e fondit limit janë marrë nga interneti, çmime ndërkombëtare të publikuara dhe pas kësaj janë shtuar të gjithë detyrimet e tjera në bazë të legjislacionit në fuqi. Bazuar në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, neni 57, Preventivi i fondit limit është hartuar nga Njësia e prokurimit, çmimet dhe specifikimet janë hartuar nga specialist i fushës i caktuar në njësinë e prokurimit.*

*Referuar Projekt-Raportit tuaj,*

*"Titulli i gjetjes nr.4", faqe 11 shpreheni se:*

*Gjetja nr.4: Mungesë të efijencës, efektivitetit dhe ekonomicitet në përdorimin e fondeve Situata: Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjenden në magazinë të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre Megjithëse një gjetje e tillë nuk ka të bëjë me detyrën që unë kam ushtruar, në observacionin e datës 07.08.2023 për akt konstatimin e lënë nga ana juaj ju kam sqaruar që nëse do ti referoheni dokumentacionit për fletë-daljet nga magazina, rezulton që në Tetor 2021 janë bërë dalje nga magazina për nevoja në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit 15 biçikleta, mbi bazën e kërkesës së tyre, pra theksojmë që janë përdorur në aktivitetet e Fakultetit.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje pjesën e observacionit në lidhje me pretendimet tuaja për sa i përket konstatimeve për procedurën e prokurimit "Blerje pajisje profesionale" arrin në konkluzionet e mëposhtme:*

*Nuk ka dokumentacion ku të paraqitet një përshkrim i të mallrave që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;duke mos justifikuar kështu blerjen e këtyre artikujve dhe shpenzimin për to, kjo në kundërshtim me VKM 914 ,datë 24.12.2014 ,neni 12,pika 2.a, "Përgjegjësia e autoritetit kontraktor" .*

*Sipas dokumentacionit të vene në dispozicion nuk ekziston asnjë shkresë për hartimin dhe përlllogaritjen e fondit limit. Fondi limit është përcaktuar nga titullari i AK-së direkt ne urdhrin e prokurimit pa ngritjen e një grupi të posaçëm për hartimin e fondit limit ose lënien e hartimit të këtij fondi njësisë së prokurimit veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Nenin,57 "Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit ,neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës" .*

*Në dokumentacionin e administruar nga UST për lëvizjen e mallrave nga magazina nuk ka kërkesa për përdorim të artikullit biçikleta për ture për periudhën kur këta artikuj janë blere, dhe asnjë dokumentacion tjetër që justifikon blerjen e këtij artikulli dhe*

*shpenzimet e kryera për të . Dokumenti i paraqitur në observacionin tuaj është i vitit 2021 ,periudhë kur janë bërë dalje nga magazina 15 biçikleta. Pra, artikujt tjerë janë gjendje në magazinën e UST, të papërdorur që nga viti 2018 ,duke mos përmbushur kështu qëllimin për të cilin janë blerë dhe duke mos i shërbyer nevojave të Universitetit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit .*

**Pretendimi i subjektit:**

*.....Siç, ju kam sqaruar dhe në observacionin e datës 06.10.2023, për aktin e konstatimit të lënë nga ana juaj, në momentin që janë kryer procedurat që ju keni audituar dhe deri në Tetor të vitit 2017 unë kam qenë në pozicionin e Kancelarit të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe referuar Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007 që ka qenë në fuqi në këtë periudhë, në pozicionin që unë kam patur nuk kam qenë Nëpunës Autorizues. Duke qenë se përveç sqarimit të dhënë keni kërkuar dhe Urdhrin e emërimit tim, bashkëlidhur po ju paraqes Vendimin e Bordit të Administrimit nr.28, datë 11.10.2017 "Për emërimin e Administratorit në Universitetin e Sporteve të Tiranës", pavarësisht se ajo mund të verifikohet lehtësisht, pasi ndodhet në protokollin e institucionit.*

*Në vitin 2018 dhe në vijim, pas ndryshimit të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe daljes së akteve nënligjore, kur kam qenë në pozicionin e Administratorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës është miratuar një rregullore për aktivet me Vendim Senati nr.9, datë 03.02.2020 "Mbi miratimin e Rregullores për administrimin e aktiveve në Universitetin e Sporteve të Tiranës", edhe pse njësitë kryesore janë të informuar për këtë vendim Senati, ju është përcjellë dhe me shkresë njëjësive brenda.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Për sa pretenduar me sipër observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

**III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM**

-Në lidhje me procedurën “Blerje pajisje profesionale”, konstatohet se për këtë procedure nuk administrohen kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes se saj.

-Në lidhje me specifikimet e vendosura të pajisjeve u konstatua se specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik.

Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjenden në magazine të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre, për artikujt:

-Biçikleta për ture copë 40 me vlerë 1,584,000 lekë me TVSH

-Set Zhytjeje copë 50 me vlerë 540,000 lekë me TVSH

Mangësi në mbajtjen dhe hartimin e dokumentacionit për procedurën “Reformimi i metodologjisë dhe teknikave të mësimdhënies, komunikimit dhe shërbimeve në UST”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914/2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’ i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.

-Nisur nga sa me sipër titullari i AK-së nuk duhet të kishte iniciuar fillimin e kësaj procedure prokurimi në mungesë të dokumenteve justifikuese nga sektorët përkatës për artikujt e tenderuar. Autoriteti kontraktor ka vepruar vetëm duke u mbështetur në plan buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm për iniciimin e kësaj procedure.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me -Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914/2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’ i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.

-Nisur nga sa me sipër titullari i AK-së nuk duhet të kishte iniciuar fillimin e kësaj procedure prokurimi në mungesë të dokumenteve justifikues nga sektorët përkatës për artikujt e tenderuar. Autoriteti kontraktor ka vepruar duke u mbështetur në plan buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm për iniciimin e kësaj procedure.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje profesionale”, me REF -066325-04-30-2018, viti 2018, u konstatuan parregullsi në hartimin e regjistrave të prokurimeve dhe identifikimin e nevojave të institucionit për pajisjet e tenderuara. Për këtë procedurë nuk janë administruar kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes së saj. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2.a, “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” si dhe me Udhëzimin nr. 09 datës 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

**1.1 Rekomandimi:** Nga UST të merren masa për administrimin e kërkesave për identifikimin e nevojave reale të institucionit për mallra dhe shërbime, duke i pasqyruar në projekt buxhetet përkatëse dhe në regjistrat e parashikimeve për prokurimet publike, sipas përcaktimeve të ligjeve në fuqi.

*Në vijimësi*

**1.2 Rekomandimi:** Nga UST të merren masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit me synim realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

*Në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisje profesionale”, të administruar në dosjen përkatëse, u konstatuan parregullsi në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Në dokumentacionin e administruar për këtë procedure mungon llogaritja e fondit limit e dokumentuar. Fondi limit është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në urdhrin e prokurimit pa ngritjen e një grupi të posaçëm për hartimin e fondit limit ose lënien e hartimit të këtij fondi njësisë së prokurimit veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Neni 57 “Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit dhe neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

**2.1 Rekomandimi:** Nga UST, njësia e prokurimit në të gjitha rastet të ndjek në mënyrë rigorozë etapat e zhvillimit dhe dokumentimit të procedurës së prokurimit me qëllim transparencën e plotë dhe arritjen e objektivave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Kërkesa kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë. Specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik.

Nga verifikimi i produkteve të ofertuar nga OE i shpallur fitues u konstatua se, karakteristikat teknike të produkteve të përshkruara në specifikimet teknike janë njësoj me katalogun e produkteve të OE fitues, duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasojë kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës. Kjo në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 20 dhe neni 23, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61.

**3.1 Rekomandimi:** Nga UST, njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që të stimulohet konkurrenca dhe që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën e kontratës.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Mungesë të eficiencës, efektivitetit dhe economicitet në përdorimin e fondeve publike. Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjendën në magazine të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre, për vlerën 2,124,000 lekë, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12.

**4.1 Rekomandimi:** UST, autoriteti kontraktor të marrin masa për argumentimin e saktë të nevojave të institucionit arritjen e një prokurimi me efektivitet, efencë dhe economicitet, duke respektuar parimin e konkurrencës.

*Në vijimësi*

**4.2 Rekomandimi:** UST, për artikujt e papërdorur të marra masa për vlerësimin e tyre dhe ti vendos në funksion të nevojave dhe shërbimeve që ka universiteti.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vëne në dispozicion rezulton që nuk ka dokumentacion për funksionimin e pajisjeve (për periudhën që kane funksionuar), dhe nuk ka dokumentacion për zëvendësimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë funksionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik” pikat 5, 6, 7, 8 dhe 10.

**5.1 Rekomandime:** UST, administratori, në çdo rast dhe për çdo element të aseteve të institucionit të ndërmarrë hapat dhe të hartojë dokumentacionin përkatës për çdo lëvizje të aseteve të blera, dhuruara apo ekzistuese të tij, pasi është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe duhet të dokumentojë veprimet e ndërmarra për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka në pronësi.

## **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Titullarit, marrjen e masave disiplinore ndaj personelit që është angazhuar në procedurat e prokurimit në cilësinë anëtarëve njësisë së prokurimit, përcaktimit të specifikimeve teknike, kërkesave për kualifikim dhe përllogaritjen e vlerave të kontratave, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit ***brenda 20 ditëve*** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ***brenda 6 muajve*** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

### **Grupi i Auditimit**

**V.B**

**S.H**